

Prejardhja	Ai është Muhamed bin Abdullah bin AbdulMutalib bin Hisham dhe Hashim ishte prej fisit Kurejsh dhe Kurejshët ishin prej Arabeve dhe Arabët ishin prej bijve të Ismailit i biri Ibrahimit ﷺ
Lindja	Lindi ﷺ në Vitin e Elefantit, në Meke, në muajin Rabie El-eul, jetoi gjashtëdhjetë e tre vite, dyzet vitet e para i jetoi si njeri i thjeshtë, dhe njëzet e tre vitet e fundit ishte Profet i Dërguar, ishte jetim, babai i vdiq para se të lindte, dhe ishte nën kujdesjen e gjyshit të tij AbdulMutalib, pas vdekjes së gjyshit u kujdes për të xhaxhai i tij Ebu Talib.
Dërgesa	U dërgua tek xhinët dhe njerëzit, cdo kush që dëgjoji për thirrjen e tij dhe nuk besoi në të është jobesimtar, kushdo qoftë ai.
Ftesa	Profeti ﷺ ftoi në adhurimin e Allahut të Vetëm, në moralet e larta dhe punët e mira, sikurse ndaloj nga idhujtaria, moralet e ulëta dhe nga punët e këqija.
Isra dhe Miraxh	U shpërngul ﷺ brenda një nate nga Mekja për në Xhaminë Makdis, pastaj u ngrit lartë në qiellin e shtatë, atje Allahu i foli atij dhe i bëri detyrë pesë namazet.
Emigrimi dhe vdekja	Emigroi ﷺ nga Mekja në Medine, atje ndërroi jete dhe u varros në dhomën e nënës së besimtarëve Aishes, Allahu qoftë i kënaqur me të.
Kumtimi	Me profecinë e tij Allahu i Lartësuar plotësoi Fenë, ai e kumtoi mesazhin e Islamit me kumtimin më të qartë, e plotësoi amanetin, i këshilloi njerëzit, luftoi dhe u përpoq në rrugë të Allahut me luftë të drejtë, me të gjitha llojet e përpjekëve.
Luftërat më të rëndësishme	Shtatë janë luftërat më të rëndësishme: Bedr, Uhud, Khandek, Khajber, Çlirimi Mekës, Tebuk dhe Hunejn.
Shtatë fëmijët e tij	Kasim, Ibrahim, Abdullahi i cili është i pastërti dhe i miri, Zejneb, Rukej, Umu Kulthum, Fatime, të gjithë vdiqën dhe Profeti ishte gjallë përveç Fatimes e cila vdiq gjashtë muaj pas vdekjes së tij.
Dymbëdhjetë gratë e tij	Hadixhja, Aishja, Seuda, Hafs, Zejneb Hilalije, Umu Selemeh Hind, Zejneb bint Xhahsh, Xhuejrireh bintul Harith, Safije bintul Huzej, Umu Habibeh Ramleh, Rajhaneh bint Zejd, Mejmuneh bintul Harith.
Gjdhënëset e tij	Nëna e tij Amineh bintu Uehb, Thuejbeh robëresha e xhaxhait të tij Ebu Lehebit, Halimeh bint Ebi Dhuejbin Sadije.
Ajetet e para që u zbritën mbi të	Fjala e Allahut të Lartësuar në suren Alek: {Lexo në Emrin e Zotit tënd që të krijoi, e krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur, lexo dhe dije se Zoti yt është më Bujari, që e mësoi njeriun të shkruajë me laps, i mësoi njeriut atë që nuk e dinte.}
Të parët që besuan në të	Nga burrat ishte Ebu Bekri, nga gratë ishte nëna e besimtarëve Hadixhe bintul Khuejlid, nga fëmijët ishte Alij bin Ebi Talib, nga robërit të liruar ishte djali që e kishte birësuar në fillim Zejd Bin Haritheh, dhe nga robërit Bilal bin Rebah.
Haxhi dhe Umra	Ka bërë katër herë umre, të gjitha në muajin DhulKadeh dhe ka bërë vetëm një herë haxh, i cili është quajtur haxhi i lamtumirës, në vitin e dhjetë të hixhretit.
Morali i tij	Allahu i Lartësuar thotë: { Me të vërtetë ti je në një moral të lartë}, nëna e besimtarëve Aishja thotë: Ishte morali i tij ﷺ Kurani.
Rëndësia e mësimit të historisë profetike	Ibn Kajim, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: Nëse besojmë se lumturia jonë në të dyja botërat është e lidhur me njohjen e udhëzimit të Profetit atëherë është detyrë për këdo që ja do të mrën vetes, dhe e do shpëtimin dhe lumturinë e saj të mësojë udhëzimin dhe biografinë, historinë e tij, aq sa të mos bëjë pjesë në atë kategori që janë të paditur për historinë e tij, dhe të futet në grupin e atyre që janë pasuesit, të dashurit dhe pala e tij, njerëzit në këtë ndahen në ata që mësojnë shumë, në ata që mësojnë më pak dhe në ata që janë të privuar, dhe kjo mirësi është në dorë të Allahut ja jep atij që e do, Allahu është Poseduesi i Madh i çdo mirësie.